

STATUTI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZIAR
EXPO GROUP

Në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Themeluesit e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "EXPO GROUP" shpk, në datë 11.12.2021, shpallin:

STATUTIN E SHOQËRISË
EXPO GROUP
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

NË KËTË STATUT DO TË RREGULLOHEN ÇËSHTJET E MËPOSHTME:

- Themelimi
- Emërtimi i Shoqërisë,
- Lloji i shoqërisë,
- Adresa e selisë së saj,
- Periudha e kohëzgjatjes,
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë,
- Kapitali Themeltar
- Llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e mbajtësve të tyre,
- Organet drejtuese,
- Administratori
- Viti financiar – Ekspertet e miratuar
- Prishja dhe Ri-organizimi i shoqërisë
- Baza Ligjore


KREU I-rë

THEMELIMI, EMRI I SHOQËRISË, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA E SHOQËRISË, SELIA (ADRESA)

Neni 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I SHOQËRISË, THEMELUESI

- Sot, më 11 Dhjetor 2021, u vendos të themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "EXPO GROUP"



Nëpërmjet këtij Statuti, me vullnet të lirë, të plote e të sinqertë, deklarohet se me iniciativen e lirë private, mbeshetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil në fuqi, në ligjin Nr. 9901, dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në Ligjin "Per QKR" në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, sipas emrit të cilësuar më lart.

- Themeluesit e shoqërisë janë:
 - o Fabian Haxhi Dajcaj, i dtl. 24-12-1975, Lindur në Krujë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal H51224078G, dhe me Nr. Leternjoftimi: 036867363.
 - o Sonila Namik Dajcaj, e dtl. 09-04-1979, Lindur në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me Nr. Personal H95409045N, dhe me Nr. Leternjoftimi: 031787474.
 - o Orion Fabian Dajcaj, i dtl. 09-12-2001, Lindur në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal K11209033R, dhe me Nr. Leternjoftimi: 033579353.

Neni 2

FORMA JURIDIKE

- Shoqëria tregtare "EXPO GROUP", është Person Juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizik/juridik te lart-përmendur, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kotributeve të nënshkuara. Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombetare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjate veprimtarisë së saj.

Ortakët gëzojnë keto kuota në shoqëri:

- o Fabian Haxhi Dajcaj 52% të kuotave në shoqëri,
- o Sonila Namik Dajcaj 24% të kuotave në shoqëri,
- o Orion Fabian Dajcaj 24% të kuotave në shoqëri,

kjo në përpjestim me kontributin që ata kanë dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë i përket tërësisht Ortakëve Themelues, sipas këtij raporti.

Neni 3

SELIA E SHOQËRISË:

- Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rr. Don Bosko, Pallati Elmar, Dyqani Nr.7, Tiranë – Shqipëri



- Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hape zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, Fanchize, si brënda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Adresa e faqes së internetit (Web-Page): www.halal.al dhe, www.expo.halal.al
- Adresa e shoqërisë për komunikim elektronik: info@halal.al
- Faqe të metejshme web, adresa email dhe forma kontakti, mund të ndryshohen, shtohen apo pakësohen në të ardhmen sipas nevojave të shoqërisë.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

- Organizim të eventeve me karakter tregtar, social-kulturor, politik, sportiv, etj, ku përgjithësisht, por jo përjashtimisht, panaiere kombëtare dhe ndërkombetare, konferenca, Kongrese, Work-shop, etj.
- Organizim dhe manaxhim të ankandeve dhe për të tretë, online dhe fizikisht.
- Ndërtimi i objekteve civile
- Shërbim në fushën e transportit tokësor, detar dhe ajror, brenda dhe jashtë Shqipërisë,
- Shërbime marketingu, prodhime filmike numerike dhe digitale, prodhim produkteve mediatike,
- Krijim dhe manaxhim i faqeve WEB dhe për të tretë, e-commerce, Radio dhe Televizion.
- Konsulencë tregtare dhe juridike
- Agjensi rekrutimi dhe punësimi, Turistike, Shit-blerje bileta të transportit tokësor, detar dhe ajror, Real Estate, Ndërmjetesim Tregtar,
- Shërbime në fushën e përkthimeve
- Shërbim certifikimi dhe standartizimi
- Auditim
- Investime dhe pjesëmarrja në investime duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera, vendase dhe të huaja, në fushën e industrisë, bujqësisë, Industrisë Ushqimore, dhe transport.
- Kryerjen e aktiviteteve të mësipërme në Shqipëri dhe jashtë saj.

Neni 5

KOHËZGJATJA



- Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar.

KREU II-të -KAPITALI-

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000(njëqindmijë) lekë.



- Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga Ortakët Themelues të Shoqërisë, dhe specifikisht:
 - o **Fabian Haxhi Dajcaj**, i dtl. 24-12-1975, Lindur në Krujë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal H51224078G, dhe me Nr. Leternjoftimi: 036867363, zotërues i 1 (nje) kuote, që përfaqësojnë 52% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 52.000(pesëdhjetëedymijë) lekë.
 - o **Sonila Namik Dajcaj**, e dtl. 09-04-1979, Lindur në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me Nr. Personal H95409045N, dhe me Nr. Leternjoftimi: 031787474, zotërues i 1 (një) kuote, që përfaqësojnë 24% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 24.000(njëzetekatërmijë) lekë.
 - o **Orion Fabian Dajcaj**, i dtl. 09-12-2001, Lindur në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. Personal K11209033R, dhe me Nr. Leternjoftimi: 033579353, zotërues i 1 (një) kuote, që përfaqësojnë 24% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 24.000(njëzetekatërmijë) lekë.
- Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
- Kontributi i Ortakëve Themelues mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/palujtshme apo të drejta)
- Ortaku që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga casti i cenimit.

Neni 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT:

- Kuotat e kapitalit të shoqërisë Expo Group shpk si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:
 - o Kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - o Shit-blerjes
 - o Trashëgimisë
 - o Dhurimit
 - o Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Ligj
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, përsa nuk parashikohet ndryshe në Statut.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimnie.



Neni 8**ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT.**

- Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga Gjykata Kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- Në të gjitha rastet, zvogëlimi i kapitalit i prek Ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë/mbajnë.

KREU III-të**ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE****Neni 9****ORGANI VENDIM-MARRËS**

- Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendim-marrës i shoqërisë.
- Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendim-marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në Ligj.
- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - o Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
 - o Ndryshimet në Statut
 - o Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve
 - o Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar.
 - o Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike.
 - o Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporeve të ecurisë së veprimtarisë.
 - o Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
 - o Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
 - o Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
 - o Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
 - o Ri-organizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - o Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.
 - o Çështje të tjera të përcaktuara nga Ligji apo nga Statuti i Shoqërisë.
- Ortaku mund të përfaqësohet në Asambleshën e Përgjithshme të Ortakëve nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi me shkrim.



Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE.

Asambleja e Përgjithshme thërritet me anë të një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pamvarësisht parregullsisë.

Neni 11

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas Nenit 87 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të Pikës 3 të Nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, Asambleja mbledhet përsëri, jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëllimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, ri-organizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b- Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve.
- c- Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar.
- d- Përcaktimin e shpërblimeve



- e- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- f- Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve.
- g- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së Asamblesë.

Çdo ndryshim në Statut duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 13**PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**


Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithme merr vendim për:

- a- Vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- c- Ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria.
- d- Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 14**ADMINISTRIMI**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vite, me të drejtë ri-përtëritje. Emërimi i Administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të këtij Ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me keto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personi(at) e mëposhtëm caktohen Administratorë të Shoqërisë deri në një vendim të dytë për shfuqizimin e tij/tyre:

Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa	Specimeni i nënshkrimit
Fabian	Haxhi	Dajcaj	Rr. Albanopoli, P. Alpha, Nr.27/4, Tiranë	

Neni 15**KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- b- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
- c- Kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë.



- d- Përgatitin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim.
- e- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- f- Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- g- Raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive të posaçme dhe me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- h- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara dhe parashikuara në Ligj dhe në Statutin e Shoqërisë.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.
- Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpëblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa-miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, të cilat i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për t'i përballuar pasojat përkatëse në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas Neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1- :

- a- Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në Ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
- b- Të ushtrojë kompetencat që i njihen në Ligj dhe në Statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita.



- c- Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merr vendim.
 - d- Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 2- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mos-veprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mos-veprimi është kryer në mirëbesim.
- 3- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të ketij neni, është i detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 4- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me Dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kryen veprimet e mëposhtme:
- a- U kthen Ortakëve Kontributet
 - b- U paguan Ortakëve Interesa apo Dividente
 - c- U shperndan aktivet shoqërisë
 - d- Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
 - e- Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, Ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale ndaj administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, nuk mund të ndalojë ngritjen e padisë kundër Administratorit ër gabime të kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV **VITI FINANCIAR – EKSPERTËT**

Neni 17 **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 18 **EKSPERTËT**



Ekspteri kontabël i autorizuar ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar, pregatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ia paraqesë e dorëzoje në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

KREU V

-PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQËRISË-

Neni 19

PRISHJA DHE LIKUJDIMI


Shpërndarja dhe prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
 - b- Me vendim të Asamblesë së Ortakëve
 - c- Me hapjen e procedurave të falimentimit
 - d- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me Pikën 3 të Nenit 43 të Ligjit 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
 - e- Me vendim të gjykatës
-
- Në rast se Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likujdatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij, emrin e likujdatorit dhe emëresën shtesë "Shoqëri në Likujdim e Sipër"
 - Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
 - Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar ose nga Ortakët.
 - Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.

Neni 20

RI-ORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI, NDARJA,

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.02.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"



Neni 21

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe Dispozitat e Legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe ShoqëritëTregtare", Kodit Civil, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

ORTAKU I VETËM

- 1- Të gjitha atributet, të drejta dhe detyrimet, të përcaktuara në këtë Statut i përkasin Ortakëve Themelues.
- 2- Të gjitha atributet, të drejta dhe detyrimet, të cilat i përkasin Ortakëve Themelues, nëse Ortakët Themelues transferojnë kapitale nëpërmjet mjeteve dhe mënyrave të parashikuara në nenin 7 të këtij Statuti, apo, nëpërmjet mënyrave a mjeteve të tjera të parashikuara në ligj, tek një apo më shumë persona të tretë, me lidhje gjaku apo jo, rrëzojnë pikën 1 të këtij neni.

Neni 23

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

EXPO GROUP

Fabian Haxhi DAJCAJ

Fabian Haxhi Dajcaj
[Signature]

Sonila Namik DAJCAJ

Sonila Namik Dajcaj
[Signature]

Orion Fabian DAJCAJ

Orion Fabian Dajcaj
[Signature]